

The works of Shime Deshpali – remembrance and memory of a diaspora

Abstract: Diasporas constitute an invaluable literary and cultural mulch of the Albanian literature. In the case of the *Arbëresh* in Italy, for instance, their legacy provided the necessary ground for the beginning of the Albanian Awakening. However, the *Arbanas* in Zara constitute a different facet of the same phenomena. Though dating back to as far as about 300 years ago, the literary works created in this milieu only appeared in the second half of the 20th century.

Musician, poet and writer Shime Deshpali from the *Arbanas*, along with playwright Josip Relja best represent such diaspora in the Albanian literature by bringing alive the spoken Albanian of *Arbanas* mirrored from the detailed research in the spiritual and psychological condition of the Albanian community in Zara.

An educated musician, Deshpali's poetry and his prose as well lead towards an inner musicality. It manifests a unique and unparalleled potential of the Albanian language thanks to the subdialect of *Arbanas*. So Deshpali's works stand out among other works in the Albanian literature in virtue of their permeating musical undertones of the fragile *Arbanas* subdialect asserting the collective memory of this diaspora.

Keywords: Arbanas, Shime Deshpali, Albanian Awakening, Albanian Literature.

Krijimtaria e Shime Deshpalit është e pandashme nga historia dhe fati i Arbëneshit. Ajo vjen si shprehja dhe dëshmia e tij fundore, kujtesë e një diaspore dhe kujtim për të. Si në shumë pamje të tjera të së njëjtës dukuri, edhe në historinë 300 vjeçare të Arbëneshit, faktor dhe aktor thelbësor mbetet lidhja e fortë me identitetin gjuhësor e kulturor dhe roli unik i tij si "kujtesë identitare".

Diasporat shqiptare, kudo ku i hodhi odisea e historisë së tyre, e kanë shndërruar identitetin gjuhësor (e kulturor të lidhur me të) në një prag ekzistencial etnik ose kombëtar. Prandaj, të shqyrtosh jetën e diasporave shqiptare nuk është si të shfletosh një album kuriozitetesh etnike, por

të thellohesh në Historinë e Kombit. Nga kjo perspektivë jeta dhe fati i diasporave na shpalosin pamjet më mbresëlënëse të historisë sonë.

Le të kujtojmë se lindja e letërsisë kombëtare në zemër të diasporës Italo-Arbëreshe, nuk shenjon vetëm një moment të çmuar për letërsinë në gjuhën shqipe, por edhe një nga etapat më të rëndësishme të Rilindjes politike kombëtare. Shkëndijës së Arbëreshëve të Italisë, i bashkohen diasporat më të reja, qofshin ballkanike, si në Bukuresht, Konstancë e Sofie, por edhe me gjerë, në Stamboll e Kajro, për të vijuar me diasporën shqiptare në ShBA (kryesisht në Boston) e cila, krahas lobimit e mbështetjes në nivel diplomatik e ndërkombëtar, përcjell vetëdijen e re të demokracisë e të lirive universale. Janë pikërisht emrat e këtyre qyteteve që do të gjenden në ballinat e librave shqip që përbëjnë panteonin e letërsisë kombëtare. Një hartografie të tillë i përgjigjen madje edhe tri dekadat e para të Shtetit të pavarur shqiptar, ndonëse ajo nis të plotësohet me qytetet shqiptare, ku më të rëndësishmet kulturalisht janë Shkodra, Korça, Elbasani e më vonë edhe Tirana. Gjithnjë e më shumë, gjatë viteve 1920-1944, jeta kulturore e politike e shqiptarëve rreket të jetë gjithëpërfshirëse e komplementare.

Regjimi komunist në Shqipëri shkaktoi thyerje të forta dhe nxiti një ridimensionim të ri të diasporës, tashmë gjithnjë e më “politike” në frymën dhe rolin e vet. Nga kjo perspektivë, mbetet po aq fakt kulturor sa edhe historik roli që luajtën Ernest Koliqi¹ në Romë dhe inteligjencia e Kosovës në Prishtinë, me themelimin e një hapësire komunikuese mes diasporave kulturore shqiptare dhe letërsisë e kulturës kombëtare, detyrë që në realitetin politik e kulturor të Shqipërisë nën diktaturën komuniste ishte tashmë e pamundur.

Bota kulturore e Kosovës, më e lirë dhe e panënshtuar ndaj “realizmit socialist”, ndaj paranojës së “të ndryshmes” në botëkuptim, në trajta gjuhësore dhe përthyerje kulturore, u bë trashëgimtarja e natyrshme, tribuna e zërit letrar e kulturor të diasporës shqiptare e cila pohonte tashmë vetveten si identitet gjuhësor e kulturor përmes letërsisë së saj të traditës dhe asaj bashkëkohore. Pikërisht në rrethana të tilla, i bashkohen rrjedhës së letërsisë kombëtare dy prej figurave të spikatura të diasporës shqiptare në Dalmaci, arbëneshët Josip Relja (1895-1966) e Shime Deshpali (1897-1981), të vetëdijsëm me gjasë se ishin “prushi i mbramë i Arbëreshit”².

Krijimtaria e tyre letrare e sheh dritën e botimit për një kohë të gjatë në faqet e revistës monumentale për nga rëndësia kulturore kombëtare

1 Spikat nën vullnetin dhe vizionin e Ernest Koliqit puna në Institutin e Studimeve Shqiptare, themeluar në Universitetin “La Sapienza”, Romë, si dhe botimi i revistës së mirënjohur *Shëjzat* më 1957.

2 Jorgaqi, Nasho, “Zëra prej së largu - Takime me Arbëreshin dhe arbëreshët e Zarës, në përmbledhjen *Larg dhe afër : udhëtime dhe meditime*, Shtëpia botuese “8 nëntori”, Tiranë, 1987, f. 270.

“Jeta e re”, e më pas, po në Prishtinë, dalin dhe librat e tyre të parë. Madje, thuhet simbolikisht, përmbledhja e parë e Deshpalit del më 1966, vitin kur Rela, mik e bashkëpunëtor i tij, ndërron jetë.

“Pa Kosovën, – rrëfen më vonë Deshpali, – s’do t’më kish njoft kush. I faleminderes fort Kosovës. Janë sjellë vllaznisht, jo vetëm me mue, po dhe me Josipin (Relën) edhe me Budimirin (Peroviqin). Nuk më kanë lanë me hup përkëndeja. Se veç ne të tre jena që shkruajmë arbnisht nga katundi.”³

Muzikant i talentuar e i mirëkultivuar, karriera e Shime Deshpalit zhvillohet qysh herët pikërisht përmes jetës muzikore si kompozitor pjesësh vokale e instrumentale, mësimdhënës i mirënjohur i disa instrumenteve dhe drejtues trupash muzikore, koresh dhe institucioneve të artit⁴. I lidhur gjithashtu me pikturën, ai e sprovon krijimtarinë letrare në një moshë relativisht të vonë. “Nuk më pengon pse mirrem me disa gjini të artit përnjherit – i rrëfëhet ai Musa Ramadanit mbas botimit të përmbledhjes së pare poetike (1968). - Sa vërej unë, ato madje i ndihmojnë njena-tjetrës”⁵. Ai boton në Prishtinë përmbledhjen e parë në prozë “Tregimet e Arbëneshit”⁶ më 1966 (rreth 70 vjeç) për të vijuar me dy përmbledhjet me poezi, “Agimet dhe parambromjet e Arbëneshit”⁷ më 1968 dhe “E vërteta”⁸ më 1972, kur ai është tashmë 75 vjeç.

“Jam mjellma e arbëneshve këtu, që po këndoj kangën e fundit” – pohon edhe vetë ai pak para vdekjes⁹. “Të kënduemit e kangës së fundit” është në fakt filli i vetëdijes që lidh të gjitha veprat e tij si dhe veprën vetë me historinë dhe fatin e vendlindjes. “Në qoftë se unë kam krijuar diçka – pohon ai, - kte e kam ba me qëllim që të ndihet Arbëneshi. T’i kallxoj botës shpirtin e katundit tem, virtytet e vllaznve t’mij, të merret vesh se na jena arbën”¹⁰. Shime Deshpali lind në Arbënesh, vepra e tij lind për Arbëneshin. Si e tillë ajo i bashkohet rrjedhës së letërsisë kombëtare, si e tillë ajo është një pamje më vete, një tingull unik që shenjon edhe një herë realitetin identitar të një ujdhesë specifike etnike e kulturore si Arbëneshi, si për të na shqiptuar me zërin e vet se thelbi i historisë së Arbëneshit do të mbetet gjuha e mëvetësishme, e

3 Idem, “Diaspora shqiptare: Zëri larg dhe afër i Shime Deshpalit”, në gazeta *Dita*, 25 mars 2018.

4 Për më tepër mbi krijimtarinë muzikore dhe rolin e tij si muzikant shih Ballata, Zeqirja, “Shime Deshpali – vetmitar i ndërgjegjes kombëtare arbëreshe”, në *Studime* nr. 10, [2003], ASHAK, 2004.

5 Ramadan, Musa, “Duert e Deshpalit”, rubrika “Portrete”, gazeta *Rilindja*, 1 qershor, 1968, f. 11.

6 Deshpali, Shime, *Tregimet e Arbëneshit*, botimet “Jeta e re”, Prishtinë, 1966.

7 Idem, *Agimet dhe parambromjet e Arbëneshit*, botimet “Rilindja”, Prishtinë, 1968.

8 Idem, *E vërteta*, botimet “Rilindja”, Prishtinë, 1972.

9 Jorgaqi, Nasho, “Zëra prej së largu...”, vep. cit. f. 282.

10 Ibid, f. 281.

folmja e Arbëneshit, si dëshmi por dhe si potencial identitar.

Duke shqyrtuar raportin e diasporës me ligjërimin, pikërisht në kuadër të shkrimtarëve të Arbëneshit, Ibrahim Rugova shkruante se ishte e gjithë “jeta dhe ekzistimi brenda atij grupi ekzistencial të shkëputur nga tërësia ekzistenciale” që do të shihej në letërsinë kombëtare “përmes atij ligjërimi” dhe se “duke bërë jetë si tërësi e grupe të veçanta ekzistenciale, diasporat nxjerrin njerëz e kulturë në fushën e ambienteve të reja si dhe në atë nacional me veçori të veçanta e specifike” – vijon ai, teksa e përkufizon dramën “Nita” të Relës si dëshnim e dramatizim i “procesit të vështirë të ambientimit dhe formave të ekzistimit të diasporave. Rela, përmes ligjërimin, gjuhës burimore (...) paraqet fatin dhe problemet e saj, inkarnim i fatit të personazheve të veprës.”¹¹

Dhe ndodh pikërisht kështu edhe në veprën e Deshpalit. Përmbledhja “Tregime arbëneshë” përmban 10 proza tregimore, kryesisht të llojit të miniaturës, ku me një gjuhë të bazuar në të folmen e Arbëneshit vijnë skena jete plot kolorit ambiential, ku sprovua ekzistenciale universale njerëzore, e sprovuar kryesisht nga pikëpamja tematike përmes temave të varfërisë e të dinjitetit njerëzor, luftës për jetën, përballjes së brezave, të së mirës me të keqen, dashurisë dhe vdekjes, xhelozisë e mirësisë, erosit e dëshpërimit, do të kalojë doemos nga prizmi i autentikes arbëneshë, i vetëdijes identitare, deri në limitet e një etike komunitare, diferencuese dhe konservuese. Autori, falë edhe perceptimit diferencues të ligjërimin specifik gjuhësor arbëneshas, krijon sugjestionin e rrallë të unikes, të asaj që ndodh si e tillë në fabulat e tregimeve pikërisht vetëm sepse në to personazhet, bota shpirtërore dhe rrethanat i përkasin ekskluzivisht (ose detyrimisht) botës arbëneshë. Lexuesit të vëmendshëm, ky tipar i miniaturave mund t’i kujtojë edhe atmosferën e përshkruar nga Tullio Erber¹² më 1883, gjatë qëndrimit në Zarrë e në Dalmaci të historianit udhëtar, ku theksohet dallueshmëria e arbëneshëve në mendësinë e jetës, sjellje, pamje e qëndrim.

“Ajo që në universalen duket rrethanore, në alteritetet bëhet thelbësore (qenësore), për të shpënë te teoria e autenticitetit, apo e origjinalitetit” – e specifikon këtë proces “diferencimi” studiuesi Sabri Hamiti¹³.

Me një mjeshtri tregimtare të mirë, në të cilën shkrihen përshkrime gati pikturale të peizazheve dhe të botës njerëzore të Arbëneshit me skena jete dialogjike ekspresive, Deshpali do të vijojë të njihet nga kritika letrare si prozator interesant edhe mbas botimit të dy përmbledhjeve poetike. E pikas këtë veti Hasan Mekuli kur mendon se “duhet pohuar se

11 Rugova, Ibrahim, “Miti i jetës” në *Refuzimi Estetik* [1982], Shtëpia botuese “Faik Konica”, Prishtinë, 2005, ff. 176-177.

12 Erber, Tullio, *La colonia Albanese di Borgo Erizzo presso Zara*, Ragusa, 1883.

13 Hamiti, Sabri, *Albanizma në Poetika shqipe : bioletra; tematologjia; albanizma*, bot. 55, Tiranë 2010.

Shime Deshpali na imponohet dhe na duket më i mprehtë, më i afërt dhe më i prirun si tregimtar¹⁴, si dhe Ali Podrimja, në shkrimin me titullin “Poezia e një prozatori”, kur pohon se “nëse marrim në tanësi me studjue krijimtarinë letrare të Deshpalit, do të zbulojmë se ai ka aftësi krijuese ma tepër në fushën e prozës”¹⁵.

Sidoqoftë, pikturalja e tij është një tipar që spikat lehtë në tërësinë e teksteve, qoftë prozë, qoftë poezi. Përshkrimet kryesisht mjedisore në prozë dhe ato të peizazhit në poezi u ngjajnë tablove të gjera që përftojnë të madhërishten përmes elementeve të pamatshme të universit dhe të botës së perceptueshme, duke nisur nga yjet, qielli, dielli, retë, malet, deti, valët, brigjet etj. Duke mbërritur te bota njerëzore pikturalja e tij synon portretizimin (fizik apo shpirtëror) të së bukurës dhe të hijshmes në intimen njerëzore dhe të natyrës në raport me njeriun ose unin poetik.

Hasan Mekuli e cilëson veprën e Deshpalit si : “një visar tablosh e panoramash mbresëlënëse nga treva përkatëse, si një botë motivesh thellësisht dhe singerisht të përjetuara”. Për kritikun më të vëmendshëm ndaj veprës së tij “mes dy përmbledhjeve poetike ekziston një ndërlidhje tematike dhe motivime e pashkëputshme, një sistem i njëjtë i të menduarit poetik, një botë përsiatjesh dhe ndjenjash të cilën lehtë mund ta njohim se është e poetit të agimeve e parambromjeve, e autorit që ka prirje të dalluara për pikturën dhe pikturimin e pejsazheve, autorit që ka vesh të hollë për muzikë”.¹⁶

Përmbledhja “Agimet dhe parambromjet e Arbëneshit” (1968) me 34 poezi, është më e plotë për nga struktura , ndërtohet në 7 pjesë si një rrugëtim poetik në tri linja tematike: natyra (e zhvilluar përmes cikleve të 4 stinëve); Dashnia (si rrëfim mbi të bukurën dhe dëshirimin); Fëmija (kryesish si zhytje në botën fëmijore). Ndërsa përmbledhja “E vërteta” sjell 19 poezi në të cilat, pavarësisht nëse kërkimi poetik ndodh drejt kujtesës kolektive (në histori e gjuhë) apo ndodh drejt kujtesës personale, individuale, ato janë në thelb rikthim ose rindërtim i së shkuarës që kërkohet të jetohet si kujtim ende veprues (aktiv) në të tashmen. Arti i Deshpalit shpallet hapur si akt kujtese. Përmes kujtesës marrin kuptim qoftë identiteti arbënesh qoftë ai personal.

Edhe këtu qendra e poetikës krijuese të Deshpalit mbetet identiteti gjuhësor dhe një ligjërim specifik letrar i ndërtuar përmes të folmes së

14 Mekuli, Hasan, “Shime Deshpali: Agimet e parambromjet e arbëneshit”, revista *Jeta e re*, 1969, nr. 6, f.1131

15 Podrimja, Ali, “Poezia e një prozatori” shkrim për *Agimet e parambrojmet të Arbëneshit*, rubrika “Në botën e librit”, *Rilindja*, 29 qershor, 1968.

16 Mekuli, Hasan, “Shime Deshpali – Këngëtari i Arbëneshit dhe i të “Pafatmes Jetës”, shkrim në vitin e vdekjes së autorit, 1981, në Shime Deshpali, *Vepra letrare*, Lidhja e shkrimtarëve e Kosovës, Prishtinë, 2015, f.26.

poetizuar arbëneshe. Këtu na duket mjaft i vlefshëm përcaktimi që i bën qysh herët kësaj poetike Hasan Mekuli teksa shkruan se “kjo asht poezi anakreontike, e cila edhe mbështetet në tingëllimin e fjalës e të vargut [...]”.¹⁷ Në fakt, leximi i disa prej poezive të tij (sjell këtu ndër mend poezinë “Katundi jem”), të shpien në atmosferën poetike sugjestive të poezisë arbëreshe e ndoshta edhe asaj deradiane.

Në përgjithësi, kritika letrare në Kosovë e ka mirëpritur krijimtarinë e Dëshpalit, ashtu si dhe atë të Relës dhe Kikicës, me dashurinë dhe kërkshërinë që ngjall bota e arbënesheve të Zarës ndër bashkëkombasit e vet. Më gjerësisht me të është marrë kritiku Hasan Mekuli, por me shumë interes mbeten edhe recensionet e shkruara nga sivëllezërit e tij poetë e shkrimtarë, ku përmendim shkrime të Ali Podrimës¹⁸, Musa Ramadanit¹⁹ etj.

Shkrimet kritike të Hasan Mekulit, paraqesin lexime serioze dhe analiza të shtrira e gjithëpërfshirëse. Ato janë lexime të mirëfillta kritike, ku krahas vlerësimeve mbi arritjen artistike të autorit jepen edhe dobësitë e tij ose vërejtje të natyrave të ndryshme, sidomos kur në fokus merret poezia e tij, prej së cilës pretendohet një vetëdije më e lartë artistike.

Por, nuk i shpëton vepra e Dëshpalit as ndonjë pretendimi që lidhet me ideologjinë e leximit apo të krijimit në diskursin kritik të Kosovës në vitet 60 dhe 70, ku prej krijimeve të reja letrare në përgjithësi kërkohej një koncept i ri i realizmit, i progresives, i kontradiktave shoqërore, i tejkalimit të tragjikës, i potencimit optimist etj. Me pak fjalë, i kërkohej Dëshpalit diçka që nuk buronte prej Dëshpalit²⁰. Megjithatë, në përgjithësi,

17 Idem, “Në margjinat e revistës “Jeta e re” në vjetin 1964”, revista Jeta e Re, nr.2, 1965.

18 “Përmes veprave të këtyne dy shkrimtarëve [Dëshpali dhe Rela] [...] ne spontanisht njohëm një botë komplekse të mveshun me të gjitha ngjyrat e jetës dhe të kohëve, njohëm botën e arbënesheve të Zarës, zakonet dhe adetet e ndryshme, dëshirat e shpirtit e tynë, kreninë dhe virtytet e tjera, mentalitetin, botën psikike dhe sociologjike. Ata ndriçuan një trevë fare të palavrueme në letrat shqipe. Posaçërisht ai ka tregue aftësi për poezi, të cilat flasin për diçka të kalueme qoftë me karakter personal qoftë me atë të përgjithshëm e që poetin e ka nxitë me mendue, me bredhë mbas fijeve të shkapërdërdhuna të kujtimeve. E kaluemia disi asht prezente gati në të gjitha poezitë. Por, nëse marrim në tanësi me studjue krijimtarinë letrare të Dëshpalit, do të zbulojmë se ai ka aftësi krijuese ma tepër në fushën e prozës.” Podrimja, Ali, “Poezia e një prozatori” shkrim për *Agimet e parambrojmet të Arbneshit*, rubrika “Në botën e librit”, *Rilindja*, 29 qershor, 1968.

19 “Me u përshëndetë me Shime Dëshpalin, domethanë me u përshëndetë edhe me Frojdin dhe arbëneshtë – dy subjekte që dominojnë çdoherë në bisedë me te – artistin plak nga mosha, por të ri në shpirt dhe punë...”, Ramadan, Musa, “Duert e Dëshpalit”, rubrika “Portrete”, gazeta *Rilindja*, 1 qershor, 1968.

20 “[...] kjo tubëz lirikash nuk përkon me kërkesat e kohës dhe me nivelin e trajtave të lirikës së tanishme përgjithësisht, e edhe ndër ne. Nuk gjejmë në të shenjat e raporteve të ndërlikuara jetësore, vërtetësitë e jetës dhe të luftës për ekzistencë, për përparim dhe kuptim të jetës etj. [...] Kurdo që Dëshpali krijon atmosferë idilike, ku i ipet frymës romantike dhe shtjellon me emfazë nuk arrin sukses. Më i drejtpërdrejtë e poetikisht

duke anashkaluar vërejtjet që lidhen me rafinimin artistik të shprehjes, kritika në Kosovë ia ka dalë mbanë të rrokë cilësitë dhe vlerat kryesore të veprës. Prej saj çmohet koloriti ambientale, evokimi dhe përkujtimi i një të shkuare thuajse akohore, forca depërtuese e kujtesës, ndërtimi ligjërimor i një bote mendore e shpirtërore sa të lashtë aq dhe të pranishme, forca dëshmuuese dhe evokuese, melodiciteti dhe ngjyresat gjuhësore, pikturalja e tij mjeshtërore etj.

Sjellim këtu disa fragmente nga kritika vlerësuese e Hasan Mekulit. Në artikullin “Tregime arbëneshë”, botuar në revistën e mirënjohur *Jeta e Re*, të vitit 1967 ai çmon pikërisht ato specifika të shkrimit të Deshpalit që e bëjnë një zë të mëvetësishëm:

- “Prej aspektit që këto tregime janë pjellë e një synimi fisnik për t’i ruejtë shum gjana të randësishme prej pamshirsisë së harresës; për të vu në pah një jetë karakteristike njerëzish në rrethin dhe botëkuptimin e të cilëve ruhen zakonet e lashta – bujaria dhe fisnikja e vjetër, rrynimet e shumnduershme dhe të mëdha të kohëve të shkueme dhe të kësaj kohe në një pellg jete të saj, në një tingull romantik apo realist, në një botëkuptim të riu apo të vjetri, nëpërmjet të një vargu të tanë pikturash të thekshme dhe interesante realiste.
- ajo zgjon në ne edhe si një transhonim specifik letrar që rrëfen për një rreth për ne shumë interesant dhe të dashtun, pra – si një varg tregimesh të llojit të posaçëm – edhe si landë letrare me një kolorit të dukshëm dhe të theksuem gjuhe dhe ambienti, me disa tipare të veçuese etnografike dhe etnologjike, të ruejtuna neper rudimentet e “fosilet” e jetës nëpër këto vise, në zakonet e lashta të të parëve, që kanë mbetë, përkundër gërshetimeve të shumta gjatë shekujve.
- Ngjyrat ambientale janë vlera ma e madhe e kësaj përmbledhje si tanësi, momenti i saj ma interesant dhe elementi mbizotnues.”²¹

Por po aq i rëndësishëm na rezulton edhe shkrimi “Shime Deshpali – Këngëtari i Arbëneshit dhe i të “Pafatmes Jetës” po me autorësi të Hasan Mekulit, shkruar më 1981, viti i vdekjes së Deshpalit:

- “Shkrimet e tij do të mbeten interesante dhe të rëndësishme si dëshmi kohësh të vështira, si panoramë jete dhe motivesh autentike në rrojtjen e arbëneshëve të Zarës, si pohim dhe transhenim artistik i shumë të vërtetave më pak apo aspak të njohura nga “koha e përmbytjes së fisit tonë arbënesh”.

padysim më i afërt është kur në vjersha, apo vetëm në ca nga strofat dhe vargjet, rrëfen për mënyrën si i përjeton dhe ndjen ai raportet sociale, me çfarë botëkuptimesh e vërenë botën dhe njerëzit etj.” Mekuli, Hasan, “Shime Deshpali: Agimet e parambromjet e arbëneshit”, revista *Jeta e re*, 1969, nr. 6, f.1131.

21 Mekuli, Hasan, “Tregime arbëneshë”, revista *Jeta e Re*, 1967, Nr. 1, ff. 144-156.

- “një visar tablosh e panoramash mbresëlënëse nga treva përkatëse, si një botë motivesh thellësisht dhe sinqerisht të përjetuara”.
- “Mes dy përmbledhjeve poetike ekziston një ndërlidhje tematike dhe motivime e pashkëputshme, një sistem i njëjtë i të menduarit poetik, një botë përsiatjesh dhe ndjenjash të cilën lehtë mund ta njohim se është e poetit të agimeve e parambromjeve, e autorit që ka prirje të dalluara për pikturën dhe pikturimin e pejsazheve autorit që ka vesh të hollë për muzikë [...]”.²²

Nuk harrojnë Mekuli e të tjerë të na dëshmojnë se ai “krijonte vazhdimisht, i brengosur, apo si thoshte vetë “i helmua prej fatit të trishtueshëm të arbëneshëve të mij”, por njëherësh edhe i vetëdijshëm për rolin që kishin ai vetë dhe krijimtaria e tij si jehonë “mbase e fundit e gjuhës sonë” në këto vise – përfundon Mekuli²³.

Nëse ndalemi pak më gjatë në receptimin dhe trajtimin thellësisht profesional që i bëri kritika e Kosovës veprës dhe figurës së Shime Deshpalit, kjo vjen së pari si dëshirë për të bërë një homazh për rolin që inteligjencia e Kosovës luajti ndaj trashëgimisë kulturore që i falën kulturës kombëtare diasporat shqiptare.

Por ka edhe një arsye të dytë. Në tërësinë e shkrimeve dhe recensioneve kritike bie në sy edhe një moment polemik në lidhje me veprën e Deshpalit, më specifikisht në lidhje me gjuhën e shkruar të krijimeve të tij. Duke u ndalur te kjo polemike besojmë se hedhim më shumë dritë mbi specifikat e krijimtarisë së tij.

Në rubrikën “Në margjinat e revistës “Jeta e re” në vjetin 1964, nr.1, 1965, Hasan Mekuli ka bërë një vëzhgim gjuhësor duke përqasur Deshpalin me Relën:

“Deshpali pikturon ambientin e Arbëneshëve, pra po ate që e njohim prej krijimeve të Josip Relës. Por gjuha e njenit dhe tjetrit ndryshojnë. Kemi përshtypjen se Deshpali asht shumë ma i lirë në të përdorunit e trajtave të specifike arbneshe. Ma mirë me thanë – përshtypjen se gjuha që përdor ai nuk asht autentike por e potencionueme dhe e pershkueme ne shumë “risina”, sepse Deshpali nuk asht konsekuent në të përdorunit e këtyne trajtave, prandaj edhe kemi të bajmë me lëkundje dhe ndryshime trajtash në mënyrë që nuk na duket e zakonshme. Por këto janë çashtje gjuhësore...”²⁴ – e mbyll argumentin pa e zhvilluar më tej Mekuli.

22 Mekuli, Hasan, “Shime Deshpali – Këngëtari i Arbëneshit dhe i të “Pafatmes Jetës”, në *Shime Deshpali, Vepra letrare*, vep. cit., ff. 9-29.

23 Ibid.

24 Mekuli, Hasan, “Në margjinat e revistës “Jeta e re” në vjetin 1964”, në revistën *Jeta e re*, 1965, nr.1.

Argumenti rimerret në numrat e mëpasshëm nga një prej njohësve dhe folësve më të veçantë të Arbënishtes, Budimir Peroviqit²⁵, i cili ndërhyr për të saktësuar se:

“Me të vërtetë gjuha e Shime Deshpalit nuk asht ajo me të cilën shkruen Rela (në dramën e tij të fundit), por po ashtu nuk asht e vërtetë edhe se Deshpali nuk asht konsekuent në përdorimin e trajtave të njëjta gjuhësore – si n’ato gramatikore, ashtu edhe n’ato sintaktike e leksike.”²⁶

Peroviq parashton në vijim të artikullit dallimin thelbësor mes ligjërimit dramatik e atij narrativ nga pikëpamja gjuhësore duke theksuar specifikat e secilit lloj:

“Kështu pra, në qoftë se e krahasojmë gjuhën e shkruese të Deshpalit me atë të “Martesës” dhe “Kungullit” të Relës, atëherë mund të shohim qartazi se kjo asht gjuhë e njëjtë, me të vetmin ndryshim që veprat e Deshpalit janë tregime, kurse ato të Relës drama, ku nuk ka huazime nga gjuha letrare. [...] Shkrimtari, pra, detyrohet të krijojë konstrukte të veta origjinale të fjalive, ndoshta edhe të drejta e në pajtim me natyrën e gjuhës sonë, por jo të rëndomta, dhe të kërkojë fjalë të cilat nuk i ka fjalori ynë lokal. Ndërkaq, për dialog, e sidomos për dramë nga jeta dhe bota e katundit, asi vështirësish gjuhësore e mungesa s’ka në të folmen tonë. [...] gjuha e Deshpalit nuk mund të jetë krejtësisht identike me të folmen e vendit tonë. Mirëpo, gjithashtu konstatojmë, se gjuha e tij nuk asht njëfarë gjuhe e re, sikundër nuk asht gjuhë e re cilado qoftë gjuhë letrare në krahasim me atë popullore.”²⁷

Në mbyllje të artikullit, Peroviq u kujton lexuesve të mbajnë parasysh edhe një fakt kontekstual, duke e vendosur “gjuhën e Deshpalit” në rrjedhën e përvojës gjuhësore të bashkësisë që e flet atë gjuhë, por duke diferencuar edhe “kompetencat” e “kujtesën” gjuhësore mes brezave të kësaj bashkësie:

“Në fund po theksojmë se gjuha me të cilën shkruen Deshpali asht kryesisht gjuhë e fqinjëve të tij nga mosha e tij rinore, me të cilën flasin ma shumë sot e kësaj dite pleq e një pjesë të këtij vendi”, - përmbyll ai polemikën e tij.²⁸

25 Peroviq, Budimir, “Nji vështrim mbi gjuhën e Shime Deshpalit”, revista *Jeta e re*, 1965, nr. 3, ff. 470-474; i njohur në botime letrare edhe me pseudonimin “Miro i Kikicës”.

26 Ibid.

27 Ibid.

28 Ibid.

Në fakt, vëzhgimet gjuhësore mbi tekstet e Deshpalit e tejkalojnë nga këndvështrimi ynë debatin gjuhësor dhe shndërrohen në çështje mirëfilli të letërsisë. Ato prekin dallimin thelbësor mes *shkrimit të gjuhës* dhe *gjuhës së shkrimit* e cila në vetvete përbën *gjuhën letërsisë* “që do të thotë – saktëson mbi këtë dallim Sabri Hamiti - gjuha në procesin e kërkimit e të krijimit të domethënies përkundrejt “shkrimit të gjuhës” si fiksion apo imitim të gjuhës së folur”²⁹.

Dhe është pikërisht ky kapërcim që e bën Shime Deshpalin ta shndërrojë shqipen e Arbëneshit në një gjuhë të letërsisë, jo thjeshtë si dëshmi gjuhësore por si esencë e krijimit letrar, esencë e letërsisë, qoftë ajo në prozë e aq më tepër në poezi, kur dihet se “[...] diskursi i poezisë, me lirinë e vet krijuese, me formën, me mbështetjen e tërësishme në figurë, është në thelb një artefakt që ndërtohet edhe përkundër normës e rendit natyral të gjuhës, a duke shkuar për anash këtij rendi [...]”³⁰.

Jo vetëm përmes vetëdijes dhe poetikave autoriale, por tashmë, edhe në studimet teorike gjuhësore e letrare, gjuha e shkrimit të letërsisë nga pikëpamja e shkrimtarit është në thelb gjuhë dhe jo dialekt. Madje, statusi i saj i vërtetë si gjuhë e letërsisë merr jetë aty ku shqiptohen limitet e vetë gjuhës si kod. Mes letërsisë “si të tillë” dhe gjuhës ka gjithmonë një tension ontologjik: ai mes së pathënshmes dhe asaj që është e thënshme vetëm artistikisht. Me fjalë të tjera, aty ku gjuha dorëzohet pulson “arroganca” e letërsisë. Ky është idiolekti, gjuha e letërsisë (për të mos u ngatërruar në këtë kumtim me “gjuhën letrare të standardizuar”).³¹

Ndaj mund të pohojmë se kujtesa gjuhësore e Deshpalit është kujtesë e gjuhës së letërsisë, është rikrijim i kujtesës së gjuhës në botën arbëneshë të rikrijuar përmes letërsisë, në skena jete, në fate njerëzore, në hetime ndjesish komplekse dhe emocionalitet të lartë. Ajo nuk mund të jetë romantike, as romantike e vonuar, as romantike përparimtare, as realiste, as realiste kritike, as pasqyrim i reales. Bota e Arbëneshit dhe letërsia për të janë dy botë paralele, prej të cilave e para e trashëgon ose e humbet kujtesën, e dyta e rikrijon atë e ia rikthen asaj të parës, si kërkim identitar dhe si kërkim estetik.

Trajtat e sprovuara poetikisht nga Deshpali janë të ndryshme. Ai e nis me një vepër poetike ku mbizotëron më së shumti një kod ligjërimit metaforik për të vijuar në veprën e fundit me një kod gjithnjë e më metonimik³².

29 Hamiti, Sabri, “Shkrimi i gjuhës / gjuha e shkrimit” në “Gjuha e letërsisë”, *Letra shqipe* [1996], *Vepra* 6, Shtëpia botuese “Faik Konica”, Prishtinë, 2002, f. 402.

30 Ibid.

31 Për më tepër shih Shehri, Dhurata & Asllani, Persida, “Si është dialektore letërsia shqipe”, në Akte të Konferencës shkencore “Letërsia shqipe dhe dialekti” – Studime Albanologjike, Nr. 2, Tiranë, 2015.

32 Për më tepër mbi kodet ligjërimore mund të shihet vepra e studiuesit Northrop Frye

Në llojet e shkrimit letrar, ajo çka përkufizohet si *kod ligjërimor metaforik* në shkrim, nuk përftohet “ndarje të fortë ndërmjet subjektit dhe objektit, po theksi bie në ndjeshmërinë që i lidh këta të dy në një forcë e në një energji të përbashkët të shprehjes. Në të dominon fjala e drejtpërdrejtë natyrore e llojit: *kjo është kjo*.”³³

“Një poet është një botë e përmbyllur brenda njeriut” – pohonte Viktor Hugo. Ajo e Deshpalit është Arbëneshi. Shembull mund të jetë poezia hyrëse “Katundi jem” në përmbledhjen “Agimet dhe parambrombjet e Arbëneshit” (1968), ku poeti ndër të tjera këndon:

O katund jem,
so të dua
me të gaxua
fjalë s’kam.
Gjisillin gurë jot
E grimcë toke jote
Të puthum në zembër
E gjak tem
E kàm.

Ndërsa në *kodin ligjërimor metonimik*, që “mund të quhet edhe ekzistencial, teksti shfaqet më i drejtpërdrejtë në angazhimin e tij social. Figurat e tij, qofshin edhe metafora tradicionale shfrytëzohen për të ilustruar një rezonim konceptual” ku autori, “subjekti, oratori, drejtohet krejtësisht jo nga vetja, por nga auditori”³⁴.

Tipike e ndërtuar përmes kodit metonimik vjen poezia “Mos më thuaj”, e cila bart së pari një qëndrim të fortë moral, por që ngrihet emocionalisht në ligjërim përmes mundësisë së një “përrjashtimi” ose “mohimit” në një përkatësi ideale të të qenit “arbënesh”, e konceptuar si një gjendje e përsosur e njeriut, e gjuhës, e identitetit – në të cilën, siç e shprehëm edhe më lart synohet një etikë sipërore identitare:

Mos më thuoj se je arbënesh
Në mos balla me nderje
Nuk të rrezaton,
Në mos syni guximisht
Nuk të vekton,
Në mos zembra parzmat
Me mburrje nuk t’i gjanon !
Këto virtyt’ në mos i ke

The Great Code: The Bible and Literature (Kodet e mëdha: Bibla dhe letërsia).

33 Hamiti, Sabri, “Kodet e mëdha të letërsisë shqipe” në *Vetëdija Letrare*, Rilindja, Prishtinë, 1989.

34 Ibid, ff. 255-258.

Ti s' di kush je
As çfarë trimbash të lavduoshëm
Stërgjyshit i ke.

Mos me thuoj se je arbënesh
Në se gjyhen jonë
Pas dore e lëshon
E me të huoj pispillohe –
E krenon,
Sepse për tingëllim të ambël
Ty gjyhës jonë
Vesh s'ke.

Dhe jo vetëm arbënesh
Po as njeri nuk je! [...]

Një rol krejt të veçantë marrin në përmbledhjet poetike *poezitë hyrëse*, te të cilat shpesh paraqiten në trajtë të poetizuar edhe kredo poetike edhe elemente të poetikës autoriale.

Si e tillë poezia “Katundi jem” shenjon arealin e përsosur mbi të cilin ngrihet kujtesa e përsosur, e zbërthyer njëkohësisht si ligjërimit, si ndjesi e emocionalitet, dhe si përkufizim sa etik aq edhe estetik, në krejt vëllimin. Arbëneshi i bukur në çdo stinë, me bardhësinë e hijshme mes ngjyrave të detit dhe dritës së diellit, fole e muzikës dhe e dashnisë, tokë njerëzish të ndershëm e krenarë, pavarësisht fatit të jetës e varfërisë, tokë e puthur prej poetit, ADN e pashlyeshme në gjakun e tij. Në një farë mënyre kjo poezi na i ka parathënë të gjitha çka vijnë pas saj: sfidën e shkrimit të stinëve të Arbëneshit si gjendje të unit poetik përballë natyrës dhe jetës, magjinë e dalldinë e dashurimit, peshën e kujtesës në zemër e në mendje etj.

Ndërsa poezia hyrëse e përmbledhjes “E vërteta”, pikërisht po me të njëjtin titull e shenjon vëllimin poetik përmes konceptualizimit etik të ligjërimit dhe prej tij të krijimit artistik. Poeti e kërkon pohimin e “së vërtetës” përmes kërkimit të një ligjërimi “të vërtetë”. Ai është një ligjërimit etik, i ngritur mbi gjuhën e kujtesës dhe identitares.

E vërteta është
e qartë
e thjeshtë.
Mo mirë është pro
me heshtë
se me përshkrua
me fjalë të mbështjelluna
e kush e di prej ka të mbledhuna.
Ajo është si artisti i vërtetë

çish s'kó nevojë m'u pispillua
Tue dashë si artist –
m'u prezantua.

E vërteta gjendet në limitin e ligjërimit. Poeti kërkon një ligjërimit të vërtetë, në zgrip të heshtjes, në kujtesën gjuhësore që i dhuron Arbëneshi i vet. Prej këndej nis kërkimi i thellë e kolektiv në historinë e të parëve, kërkimi në gjuhë, por edhe kërkimi personal në të shkuarën e dashurive të dikurshme si dhe pengu intim për dashuritë e së tashmes. Formulimi i kësaj të vërtetë nuk është i lehtë. Shqiptimi i saj po ashtu. E aq më pak leximi!

Dhe këtu mbërrijmë në një aspekt tjetër të krijimtarisë së Deshpalit. E shkëputur nga konteksti i saj gjuhësor e historiko-letrar, dhe e parë në mënyrë të përveçme përmes analizës së mjeshtërisë së vargut dhe të sistemit poetik, shumë prej vargjeve të tij ngjajnë ndoshta të thjeshta në figuracion, me rima foljore fundore, me perifrazë përshtatëse e ndoshta edhe disi naive. Ai vetë është i vetëdijshëm për shumë nga kufizimet e veta dhe siç e theksuam edhe më lart, kritika nuk ka hezituar t'ia verë ato në dukje duke shpresuar potencialisht më shumë prej tij.

Por ka diçka që Shime Deshpalin nuk e braktis kurrë, as në fjalinë më të parëndësishme të tregimeve të veta dhe as një vargun më të zbehtë të poezive të tij: muzika, rrjedha dhe harmonia tingullore që na sjellin një nga pamjet më interesante të veprës së tij: muzikalitetin gjuhësor.

Muzikë mbi gjithçka tjetër – shpallte poeti Verlaine thelbin e poetikës së vet simboliste. Kjo muzikë te Deshpali vjen si një harmoni gjuhësore që vetëm e tillë mund të sigurojë “të vërtetën” e ligjërimit poetik. Ajo nuk është e kërkuar, nuk zhvillohet përmes qasjes tipike formaliste, por duke shfrytëzuar potencialet sonore të gjuhës së folur, tingëllimit të saj, potencës prozodike, zgjatjes së zanoreve dhe diftongut specifik fundor arbënesh. Por si një muzikant i vërtetë, atëherë kur ia dikton metri, apo ritmi, ai krijon një rrjedhë krejt të veçantë melodioze të ligjërimit poetik.

Ky tipar është pikasur qysh herët edhe nga kritika. Bie në sy fakti se në disa raste ky orientim muzikor i autorit është çmuar si element specifik i tij dhe i suksesshëm, ndërsa në disa të tjera është trajtuar si një dobësi që zbeh forcën e kumtit dhe figuracionin poetik. Disa shembuj:

“Zaten, kjo asht poezi anakreontike, e cila edhe mbështetet në tingëllimin e fjalës e të vargut [...] Ai me të vërtetë ka vesh të hollë për me e dallue atë që asht poetike prej asaj që nuk asht, por nganjherë i prin melodia dhe ai e kundron jetën dhe poezinë në te vetëm nëpërmjet fillimeve anakreontike, ngazëllyese më tepër se jetësore.”³⁵

“ [Dimensioni tjetër që] përkon me gjuhën e Deshpalit, me leksikun

35 Mekuli, Hasan, “Në margjinat e revistës “Jeta e re” në vjetin 1964”, tekst cit.

dhe trajtat gjuhësore, me sintaksën dhe, në përgjithësi, me melodinë dhe ngjyrat e lashta dhe të ruejtuna aq mirë – asht temë në vedi, aplikohet dhe urdhnon hetime, që obligon dhe asht temë e gjanë dhe interesante”³⁶.

“[...] ka gjasa se [muzika] e cyti që të sprovovë forcat e veta edhe në gjini të tjera të artit në përgjithësi”³⁷ – e përkufizon në portretin për të personalitetin krijues të Deshpalit, Musa Ramadani.

Sot, duke e vështruar veprën e Deshpalit nga pikëpamja e muzikalitetit mund të dilet në përfundimin se ky muzikalitet duhet konsideruar si një formante bazë e krijimtarisë së tij. Po të hetojmë lojën “muzikore” me poezinë “Malli”³⁸, ku 8 vargjet e para jambike, thyhen papritmas nga një tercinë trokaike siç paraqitet në vijim:

Malli

Mbas se jemi takua	(u -)	3
Të parën herë		2
Të kam ndie		2
Në të jaseminit		3
Të ambël erë.		2
Të dytën herë –		2
Si hija m’je dukë		3
Si hija zhdukë...		2
Prapë i vetëm kam mbetë:	(- u)	3
“A takohem edhe ndonjiherë?”		3
Vetveten ndijoj tue pëvetë.		3

dallojmë se si përftohet një thyerje ritmike, pa sjellë diferencim grafik në stofa, procedë tipike e këngëve strofike.

Një shembull tjetër mund të vijë prej ndërtimit të një aliteracioni që bazohet pikërisht te shfrytëzimi i diftongur arbëreshas, në poezinë “Vizion”³⁹:

Era tërbuoshëm ko ulurua,
Vajtua,
Fishkëllua...
Tallacat me erë tu’rrokë
Tmerrshëm kanë buçitë,
Rrënkua,
Gurdullua.

36 Idem, “Tregime arbëneshe”, tekst cit.

37 Ramadani, Musa, “Duert e Deshpalit”, tekst cit.

38 Deshpali, Shime, “Malli”, *E vërteta*, vep. cit., f. 13.

39 Ibid. f. 25.

“Imazhi akustik” i tekstit përkon me imazhin viziv, plasticitetin e lëvizjes së stuhisë, të cilit i bashkëvendoset ulërime e erës dhe përplasjet plot eko dhe zhurmë të tallazit të detit. Por ai përgatit edhe imazhin e “vizionit” historik përmes edhe një trajte arkaike ligjërimi. Skena e stuhisë dhe arkaizmi gjuhësor përgatisin kështu përfytyrimin e anijeve ilirike të Teutës dhe betejave antike.

Ndërsa, në vëllimin e parë, “Agimet dhe parambromjet të arbëneshit”, ndeshen edhe krijime të muzikuara në trajta të ndryshme ku më së shumti “muzikaliteti dhe melodia është ajo poentë që i ka pri, parasëgjithash, ajo e mandej ideja dhe refleksi i poezisë si tërësi”⁴⁰. Poezitë kanë shënimin autorial të tipit: këto vjersha autori i kompozoi për recitim të përcjellun me piano – poezia “Funtona jonë”; këto vjersha i kompozoi autori për kor të përziem – poezia “Lenës”; këto vjersha autori i kompozoi për zo e piano – poezia “Ndeshja”. Kjo e fundit vjen sërish me një thyerje ritmike të brendshme, ku vargjet trokaike thyen me vargje jambike që marrin rolin e një refreni të brendashkruar melosit të poezisë, ndihmuar edhe nga zhvendosja e theksit logjik në fund të vargut, për ta mbyllur më pas sërish me trokeun fillestar.

Në përgjithësi, mund të thuhet se poezia e Deshpalit ia ka dalë të potencojë në shkrimin letrar muzikalitetin e një gjuhe komunitare të izoluar, të nuancuar, të reduktuar ndoshta në mundësitë e veta të shprehjes së artikuluar, por që ai e shndërron atë “në gjuhën e duhur” pikërisht duke potencuar muzikalitetin e saj, ashtu sikundërse çdo muzikant e di se cila është nota e duhur në rrjedhën e muzikës që ai krijon.

Leximi dhe shqyrtimi i sotëm i veprës së Deshpalit, qoftë në kontekstin e trashëgimisë kulturore të arbëneshëve të Zarës, qoftë edhe në kontekstin më të gjerë të letërsisë kombëtare, do të duhej të mbante gjithmonë parasysh formante muzikore të krijimtarisë së tij.

Po aq interesant është Deshpali në muzikën e prozës së tij. Në disa prej tyre shfaqet një melodiciteti i përgjithshëm i frazës, sidomos në fragmentet e përshkrimeve, që i qaset poezisë së tij, thuajse me të njëjtat cilësi metrike e tingullore. Disa shembuj:

“Terri filloi m’u rrotullua, jellat m’u zbardhua e qiell m’u vishë në ngjyra të çuditshme tue pritë lemjen të diellit. Deti ko shushurua

40 Këtë e vëren qysh në fillim Hasan Mekuli kur flet për përmbledhjen poetike *Agimet e parambromjet e Arbëneshit*: “Natyra e këtyre poezive ndoshta ndryshon prej asaj të zakonshmes, asaj me të cilën jemi mësuar në produktionin poetik ndër ne. Sepse këto janë më shumë poezi të cilat autori, qoftë me vetëdije qoftë ndërdijshëm, i ka krijuar për komponim (bile shumicën e tyre). Disa madje edhe i ka komponuar. E kjo don të thotë se muzikaliteti dhe melodia është ajo poentë që i ka pri, parasëgjithash, ajo e mandej ideja dhe refleksi i poezisë si tërësi”. Mekuli, Hasan, “Shime Deshpali: Agimet e parambromjet e arbëneshit”, tekst cit.

ambël e flutrimi i zogjve nëpër strupca e gardhnje. U shtri tingëllimi i kumbonës dridhshëm, e pak ko pak u ngjodhën e shpiat e Mazis, të grumbulloma për anë detit.”⁴¹

“Ajo, e ulum në bôrë, edhe së largut e ka shigua me shkëllexim të ambël në sy tue gërzatë fijen e bôrit me dhamb të bardhë e të shëndosh. Të dy i kapi dëshiri i madh, e pô tepër fjalë u uli e aj në bôrë e filloi me puthë. Ajo tu’u dridhë u përputhi e u përqafoi flakë.”⁴²

Pohimi i tij i dikurshëm se “nuk më pengon pse mirrem me disa gjini të artit përnjiherit, sa vërej unë, ato madje i ndihmojnë njena-tjetrës”, ngjan se vërtetohet lehtësisht në tërësinë e krijimtarisë së tij.

Në mënyrë të figurshme po e përkufizojmë si ngërthim harmonik të dy prirjeve imanente të tekstit të Shime Deshpali: *ut pictura poesis* dhe *ut musica poesis*.

Kështu Shime Deshpali bëhet një nga zërat më melodiozë të realitet letrar diasporik në letërsinë shqipe, me dëshminë e gjuhës së folur dhe me kërkimet e holla në gjendjet shpirtërore e psikologjike të njerëzve të bashkësisë arbëneshe. Muzikant i kultivuar, krijimtaria e tij shkon drejt një muzikaliteti precioz, si një kërkim unik në potencialet e rralla të gjuhës shqipe nën trajtat e të folmes së Arbëneshit. Ajo bëhet pjesë e letërsisë shqipe pikërisht si një kujtesë muzikore e gjuhës së brishtë “arbënesh” që shqipton kujtesën por edhe kujtimin e një diaspore.

Dhe për këtë “kujtesë” vetë autori e ka thënë fjalën e fundit:

“Di me thanë veç se kujtimi që po lamë, asht i ndershëm, i dli rë si dielli ...!”

41 “Urata e muratorit Joksit”, *Tregime arbëneshe*, vep.cit., f. 11

42 “Konflikt”, Ibid. f. 21